



**Republika e Shqipërisë
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

RAPORT

Për

Veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1 Janar – 31 Dhjetor

Viti 2016

Tiranë, Mars 2017

PËRMBAJTJA E LËNDËS

faqe

I.	VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË	2
I.1	Burimet njerëzore.	2
I.2	Raportet financiare vjetore të partive politike për vitin 2015	4
I.3	Auditimi i fondeve të partive politike	4
I.3.1	Auditimi i fondeve për vitin kalendarik 2014	4
I.3.2	Auditimi i fondeve të fushatës për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2015	5
I.4	Buxheti i KQZ-së për vitin 2016	7
I.5	Hapja e kutive të votimit dhe e kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet vendore të vitit 2015	8
II.	KËRKESA PËR REFERENDUME NGA GRUPE NISMËTARE	8
III	PLOTËSIMI I VAKANCAVE TË NJOFTUARA NGA KUVENDI	10
IV	TRAJNIME TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR ADMINISTRIMIN ZGJEDHOR JASHTË PERIUdhËS ZGJEDHORE, PËR PERSONA TË INTERESUAR	10
V.	ORGANIZIMI I PROGRAMEVE PËR EDUKIMIN ZGJEDHOR TË SHTETASVE JASHTË PERIUdhËS ZGJEDHORE	13
VI.	ORGANIZIMI I ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË DIBËR DHE KOLONJË	16
VII.	VEPRIMTARIA E KQZ-SË PËR PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN 2017	21
VII.1	Përgatitja e infrastrukturës zgjedhore	21
VII.2	Plotësimi me module/programe kompjuterike të nevojshme të Sistemit të Integruar të manaxhimit Elektronik të Informacionit Zgjedhor	22
VII.3	Plani orientues i veprimeve	23
VII.4	Aktet e miratuara në KQZ, gjatë vitit 2016, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 16 qershor 2017	24
VIII	AKTIVITETE ME PARTNERË NDËRKOMBËTARË	24
VIII.I	Grupi Ndërkombëtar i Punës për Zgjedhjet - (IEWG).	24
VIII.II	Konferenca e 25-të vjetore e Shoqatës Europiane të Zyrtarëve Zgjedhor (ACEEEO).	25
VIII.III	Partneriteti me institucionet homologe dhe Organizma Ndërkombëtare	25
IX.	VERIFIKIMI I VETËDEKLARIMEVE TË FUNKSIONARËVE (DEKRIMINALIZIMI)	27

I. VEPRIMTARI TË PËRGJITHSHME TË KQZ-SË

I.1 Burimet njerëzore.

Veprimtaria për rritjen e efektivitetit të burimeve njerëzore, bazohet në detyrimet e përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, Ligji për nëpunësin civil, Kodi i Punës, Rregullorja për organizimin e funksionimin e KQZ-së si dhe Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e administratës së KQZ-së.

Struktura organike e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është e përbërë nga 55 punonjës: 7 anëtarë, 30 nëpunës civilë dhe 18 punonjës mbështetës, nga të cilët, në nivele drejtuese administrative, janë: pozicioni i Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive (7) dhe i Përgjegjës të Sektorit (4).

Gjatë vitit 2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve propozoi shtesa në strukturën e tij, me efekte financiare, që u miratuan me ligjin nr.130, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017". Keto shtesa të propozuara, në bazë të Vendimit të KQZ-së për miratimin e buxhetit afatmesëm, janë argumentuar për detyra të shtuara në administratën e KQZ-së, bazuar në:

- Detyrimet e zbatimit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimin/vendimet përkatëse të Kuvendit, në aspektin ligjor të përgatitjes dhe kontrollit, jo vetëm të dokumentacionit shkresor, por edhe të gjitha akteve nënligjore, të cilat kërkojnë miratimin e KQZ-së. Siç dihet, numri i formularëve të vetëdeklarimit që regjistrohen, administrohen, përpunohen dhe verifikohen në një kohë relativisht të shkurtër, si dhe zbatimi i ndalimeve, nëse ka, për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, e bën më të domosdoshëm fuqizimin e strukturave përkatëse.
- Gjithashtu KQZ-ja, si organi më i lartë përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve, ka detyrimin, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor, të auditojë dhe të bëjë transparencën e fondeve të përfutuara dhe të shpenzuara nga partitë politike, gjatë fushatës zgjedhore si dhe jashtë periudhës së fushatës zgjedhore. Kjo kompetencë e KQZ-së, sipas përcaktimeve të ligjit, përmbushet edhe nëpërmjet kontrollit të dokumentacionit financiar e të llogarive kontabël të partive politike, të subjekteve të lidhura, drejtpërdrejt ose tërthorazi me partitë politike apo që ndodhen nën kontrollin e tyre.
- Kërkesa për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në proceset proceset zgjedhore, si dhe duke u mbështetur në VKM nr. 778, datë 07.11.2012 "Për miratimin e standardeve të përgjithshme, minimale, të personelit NJTIK për strukturimin organizativ të njësive të teknologjisë së

informacionit e të komunikimit”, ka bërë që të kërkohen shtesa edhe për këto funksione.

Miratimi i disa pozicioneve të punës , për vitin 2017, solli ndryshime në rritjen e numrit të përbërjes së administratës në 65 punonjës, kundrejt administratës së mëparshme me 55 punonjës. Megjithatë, në vlerësim tonë, për të realizuar si duhet detyrat, veçanërisht për auditimin e financave të partive politike, për procesin e dekriminalizimit dhe vendosjen në funksionim të plotë të Qendrës së Trainimeve Zgjedhore, ka nevojë për shtesa të tjera në numrin e punonjësve të administratës së KQZ-së. Kemi bërë kërkesë në organet përkatëse, përfshi dhe Kuvendin, për:

- krijimin e një strukture të posacme (sektor), duke përdorur kapacitetet aktuale të KQZ-së dhe duke shtuar 2 pozicione pune me kohë të plotë në Drejtorinë e Financave, një pozicion i nivelit të ulët drejtues dhe një pozicion i nivelit ekzekutiv;
- krijimin e një strukture të posaçme përgjegjëse (sektor) për dekriminalizimin, duke përdorur kapacitetet aktuale të KQZ-së dhe duke shtuar 2 pozicione pune me kohë të plotë në Drejtorinë Juridike, një pozicion i nivelit të ulët drejtues (shef sektori) dhe një pozicione i nivelit ekzekutiv (specialist);
- shtimin e dy pozicioneve të punës të nivelit ekzekutiv në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhesve, për Qendrën e Trainimeve.

Duke vlerësuar e konsideruar si faktor të rëndësishëm, menaxhimin e drejtë dhe racional të burimeve njerëzore, si dhe kusht për sigurimin e cilësisë së punës në administratë, **rekrutimi dhe përzgjedhja**, janë faktorë të rëndësishëm, pasi ato ndihmojnë në sigurimin e një stafi të duhur kualifikues. Në mbështetje të legjislacionit për marrëdhëniet e punës, e procedurave të pranimit, në plotësim të vendeve të reja të punës, në disa pozicione pune të Shërbimit Civil të krijuara gjatë vitit 2016, janë ndjekur të gjitha procedurat sipas rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi nëpunësit civilë, për rekrutimin e nëpunësve civilë. Gjatë këtij viti u rekrutuan: 1 pozicion pune i kategorisë ekzekutive dhe 1 pozicion pune i kategorisë së mesme drejtuese.

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, është rruga kryesore e cila kontribuon në rritjen e aftësive individuale, strukturave të institucionit, që arrihet nëpërmjet një qasjeje të qëndrueshme dhe të suksesshme nga procesi **i trajnimit**.

Në vitin 2016, janë kryer trajnime specifike të një pjese të stafit të KQZ-së, lidhur kryesisht me tematika mbi detyrat e tyre funksionale, si:

- Mirëqeverisja dhe antikorrupsioni, organizuar nga ASPA në bashkëpunim me koordinatoren kombëtar për antikorrupsionin,
- Klasifikimi dhe ruajtja e dokumentacionit, organizuar nga Arkivi i Shtetit,

- Trajnimi me koordinatorin për të drejtën e informimit,
- Trajnimi për modulet e sistemit HRMS, për sistemin e pagave, që do kalojnë on-line,
- Stafi ka qenë prezent në seminare të zhvilluara nga organizmat ndërkombëtare që operojnë (veprojnë) në fushën e zgjedhjeve;

Në bashkëpunim me ASPA-n, janë ndjekur në mënyrë korrekte trajnimet e detyruara të punonjësve në periudhë prove, sipas legjislacionit në fuqi.

I.2 Raportet financiare vjetore të partive politike për vitin 2015

Ligji nr.10374, datë 10.02.2011 "Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar", në nenin 23, parashikon se partitë politike duhet të dorëzojnë raportet financiare në KQZ. Modeli i këtij raporti, në zbatim të ligjit të sipërcituar, (neni 15/2), është miratuar me vendimin e KQZ-së, nr.3, datë 18.01.2012 "Për miratimin e rregullave për formatet e standardizuara për raportimet financiare të partive politike, subjekteve zgjedhore dhe raportimet e kontrollit financiar të ekspertëve kontabël", të ndryshuar. Afati i dorëzimit të këtij raporti, sipas Vendimit të sipërcituar, është data 31 mars e vitit pasardhës. Për vitin kalendarik 2015, nga 125 parti politike të regjistruara në Gjykatë e Rrethit Tiranë, kanë dorëzuar raportet financiare vjetore në KQZ, vetëm 26 parti politike, si: Fryma e Re Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Demokratike, Partia Demokracia Sociale, Partia Socialiste e Shqipërisë, Aleanca Kuq e Zi, Partia Aleanca Popullore, Partia Forca Rinia, Partia Kristiandemokrate e Shqipërisë, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Partia Demokristiane e Shqipërisë, Partia Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane, Partia Balli Kombëtar, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Fronti i Majtë, Partia G99, Partia Komuniste e Shqipërisë, Partia Lëvizja Punëtore Shqiptare, Partia MEGA, Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, Partia Personat me Aftësi të Kufizuara, Partia Popullore Kristiandemokrate e Shqipërisë, Partia Republikane Shqiptare, Partia Socialpunëtore e Shqipërisë, Partia Toleranca e Re, Partia Socialdemokrate. Raportet financiare të partive politike për vitin 2015 janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së.

I.3 Auditimi i fondeve të partive politike

I.3.1 Auditimi i fondeve për vitin kalendarik 2014

Për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2014, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr.10374, datë 10.02.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar", KQZ me vendimin nr.969, datë 10.08.2015 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2015 dhe për vitin

kalendariq 2014", përzgjedhi me short dhe emëroi **17 ekspertë kontabël të licencuar për auditimin e 124 partive politike** të regjistruara në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

KQZ administroi raportet e auditimit dhe përgatiti një material mbi bazën e opinionit të shprehur në këto raporte nga ekspertët kontabël. Në përfundim të procesit të verifikimit të raporteve të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2014, rezultoi se nga 124 parti politike të cilat duhet të auditoheshin:

- 74 parti politike, nuk u arrit të kontaktoheshin nga ekspertët kontabël të kontraktuar nga KQZ.
- Për 36 parti politike, ka deklaratë të kryetarit të partisë ose të të autorizuarit të tij, se partia nuk ka përfituar dhe shpenzuar fonde për vitin 2014.
- Për 14 parti politike, ekspertët kontabël kanë paraqitur një raport të rregullt auditimi. Për këto parti politike, eksperti nuk ka vërejtje për mënyrën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

Raportet e auditimit janë publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së. KQZ nuk ka kapacitete të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të bërë verifikime të mëtejshme, në lidhje me fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore, për qëllime të aktivitetit të tyre vjetor. KQZ ka bërë në mënyrë të përsëritur kërkesën për disa shtesa në strukturën organikën e saj, me qëllim krijimin e një strukture të posacme të specializuar për të mundësuar përgatitjen për kryerjen e veprimeve konkrete në zbatim të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, dhe Kodit Zgjedhor. Me shtesat e kufizuara në strukturën organikën të miratuara në organikën e KQZ-së për vitin 2017, KQZ vetëm mund të marrë masa për hartimin e rregullave të brendëshme për verifikim dhe hartimin e formateve të standartizuara për raportimin e financave të partive politike. Mendojmë, që të mund të bëhet auditim i plotë i financave të partive politike në fushatën zgjedhore dhe për vitin kalendarik, duhet miratim i shtesave të tjera të kërkuara nga KQZ.

I.3.2 Auditimi i fondeve të fushatës për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të vitit 2015

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, në nenin 91, parashikon se jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, apo kandidat të propozuar nga zgjedhësit, KQZ emëron me short, një apo më shumë ekspertë kontabël të licencuar, të përzgjedhur sipas nenit 92 të këtij Kodi, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore.

Për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike të regjistruara si subjekt zgjedhor, apo për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 qershor 2015, KQZ me vendimin nr.969, datë 10.08.2015 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar, për të kryer auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore 2015", përzgjedhi me short dhe emëroi 22 ekspertë kontabël të licencuar për auditimin e 61 partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore dhe 26 kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit.

KQZ administroi raportet e auditimit dhe mbi bazën e opinioneve të shprehura nga ekspertët kontabël në këto raporte auditimi, konstaton se:

- 1 subjekt zgjedhor, kandidati i mbështetur nga zgjedhësit Luan Frrok Fufi, nuk ka pranuar të bashkëpunojë me ekspertin.
- 8 subjekte zgjedhore, 2 parti politike dhe 6 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit, nuk kanë arritur të kontaktohen nga eksperti kontabël. Konkretisht: Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, Partia Fronti i Majte, Agron Memushi, Kristo Duci, Madalena Nikolli, Llazi Deti, Fatmir Shero, Gjon Pjetri.
- 1 subjekt zgjedhor, Partia e Pajtimit Kombëtar, nuk i ka venë në dispozicion ekspertit kontabël dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e auditimit.
- Për 8 subjekte zgjedhore, ekspertët kontabël kanë vërejtje për justifikimin e shpenzimeve të fushatës dhe u është lënë detyrë për t'i regulluar. Nga ana e ekspertëve kontabël, kjo gjë nuk është konsideruar materiale, në kuptimin e parimeve të kontabilitetit, pra shuma e shpenzimeve të pa shoqëruara me faturë të rregullt tatimore në raport me totalin e shpenzimeve të fushatës nuk është e konsiderueshme. Për këtë arsye KQZ nuk ka vendosur sanksione ndaj subjekteve zgjedhore për këtë qëllim.
- Për 69 subjekte zgjedhore, 59 parti dhe 14 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit, ekspertët kontabël në raportet e auditimit nuk kanë konstatuar shkelje të ligjit për mënyrën e përgatitjes së pasqyrave financiare, si dhe parashikimeve të Kodit Zgjedhor, për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore.

Në këto 69 subjekte zgjedhore, 35 subjekte zgjedhore nuk kanë shpenzuar asnjë fond për qëllime të fushatës zgjedhore, ndërsa 34 subjekte zgjedhore kanë shpenzuar, për qëllime të fushatës zgjedhore, nga 13 mijë lekë deri në 110 milionë lekë.

Në përfundim, KQZ me vendimin nr.10, datë 29.04.2016 "Për shqyrtimin e raporteve të auditimit për financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore 2015, raportet e auditimit për financimin e partive politike për vitin kalendarik 2014 dhe vendosjen e

sanksioneve administrative”, vendosi 10 sanksione administrative me gjobë, për dy parti politike dhe 6 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit. Nga këto 8 sanksione në masën 1 milionë lekë për mosbashkëpunim me ekspertin e emëruar nga KQZ, dhe 2 sanksione në masën 2 milionë leke, për refuzim të bërjes transparente të burimeve të financimit të fushates.

KQZ, në zbatim të dispozitave të Kodit Zgjedhor ka kryer të gjitha procedurat e parashikuara, në lidhje me auditimin financiar të subjekteve zgjedhore për fushatën, si dhe ka nxjerrtë të gjitha aktet nënligjore.

KQZ, sipas Kodit Zgjedhor, emëron ekspertët kontabel të licensuar për të audituar fondet e përfutuara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore (parti politike që marrin pjesë në zgjedhje dhe kandidatet e propozuar nga zgjedhësit).

Raportet e auditimit për cdo subjekt zgjedhor, publikohen në faqen e webit të KQZ-së dhe në buletin e zgjedhjeve. Në cdo rast KQZ ka publikuar dhe listën e personave që kanë dhuruar mbi 100 mijë lekë për cdo subjekt zgjedhor. Ekspertet kontabël, kanë raportuar në lidhje me zbatimin e detyrimeve të Kodit Zgjedhor, nga cdo subjekt zgjedhor.

Edhe pse KQZ ka zbatuar në mënyrë të përpiktë dispozitat e Kodit Zgjedhor, perceptimi në publik është krijuar se auditimi financiar është jo efektiv se, partitë shpenzojnë shuma më të mëdha se ato që deklarojnë, apo se burimi i financimit në disa raste mund të jenë të dyshimta.

KQZ po bashkëpunon me ekspertë të huaj, si rezultat i përfshirjes në projekte të financuara nga Delegacioni i Bashkimit Europian, apo nga Këshilli i Evropës, për hartimin e formateve të standartizuara për raportimin financiar, apo dhe për përthithjen e eksperincave të konsoliduara të këtyre vendeve për këtë fushë. Megjithatë auditimi financiar, përsëri do të bëhet në bazë të dispozitave në fuqi të Kodit Zgjedhor, të cilat sipas mendimit tonë me gjithë vullnetin e mirë të treguar nga institucioni, rezultojnë jo shumë efektive për realitetin shqiptar në lidhje me financat e partive politike.

I.4 Buxheti i KQZ-së për vitin 2016

Me ligjin nr.147/2015 “Për buxhetin e vitit 2016”, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, iu vunë në dispozicion 90 milionë lekë për programin “*Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*”, të detajuara: shpenzime për paga 60 milionë lekë, shpenzime për sigurime 8 milionë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime 18.46 milionë lekë, transfertat korrente të huaja 300 mijë lekë, transfertat për buxhetet familjare dhe individët 240 mijë lekë, investime 3 milionë lekë.

Gjithashtu, me VKM nr.219, datë 23.03.2016 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, KQZ-së iu shtua fondi prej 15.518 milionë lekë në zërin e shpenzimeve kapitale. Kjo shtesë fondi, në këtë zë të

shpenzimeve, u bë pas kërkesës së KQZ-së, për fonde shtesë, me qëllim mobilimin e zyrave të reja. Në zbatim të buxhetit të akorduar, u realizuan procedurat prokuruese për sigurimin e bazës materiale, për funksionim e institucionit konform legjislacionit në fuqi të prokurimeve publike.

Me VKM nr.622, datë 01.09.2016 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve", u shtuan fonde në shumën 8 milionë lekë, në programin "Zgjedhje të përgjithshme dhe lokale", për organizimin e zgjedhjeve zgjedhje të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Dibër.

Me VKM nr.787, datë 9.11.2016 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve", u shtuan fonde, në shumën 4.9 milionë lekë, në programin "Zgjedhje të përgjithshme dhe lokale", për organizimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kolonjë.

Fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, u përdorën me efikasitet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për manaxhimin e fondeve publike.

I.5 Hapja e kutive të votimit dhe e kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet vendore të vitit 2015.

Një nga veprimtaritë në vitin 2016 për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ishte edhe hapja e kutive të votimit dhe e kutive të materialeve zgjedhore, të përdorura në zgjedhjet vendore të vitit 2015.

Në zbatim të nenit 178, pika 6 e Kodit Zgjedhor, 6 muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të votimit, KQZ, me vendimin Nr. 3, datë 19.02.2016, "Për hapjen e kutive të votimit dhe kutive materiale zgjedhore të përdorura për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015", miratoi dhe filloi procedurat për hapjen e tyre. Për herë të parë, në vendimmarrjen e saj, KQZ, përcaktoi mënyrën e asgjësimit të fletëve të votimit me riciklim të letrës, duke kursyer shpenzime buxhetore, dhe njëkohësisht duke dhënë një shembull për respektimin dhe ruajtjen e mjedisit.

Proceset e ndjekura nga komisioni i posaçëm i krijuar nga KQZ, përfshinin hapjen e rreth 16,000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) kutive të votimit dhe të kutive të materialeve zgjedhore, sistemimin dhe dhënien për riciklim të fletëve të votimit, pastrimin e kutive dhe administrimin e dokumentacionit.

II. KËRKESA PËR REFERENDUME NGA GRUPE NISMËTARE

Gjatë vitit 2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar pesë kërkesa të grupeve nismëtare, në lidhje me fillimin e procedurave për referendume vendore, të iniciuara prej tyre. Të gjitha kërkesat kanë qënë të iniciuara nga një grup prej 12 nismëtarësh, në lidhje me zhvillimin e referendumeve vendore në Bashkinë Tiranë. Kërkesat e grupeve të nismëtareve, të paraqitura pranë KQZ, kanë pasur për objekt, si më poshtë:

1. Fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, në nivel të njësisë bazë të qeverisjes vendore, duke iu drejtuar zgjedhësve për çështjen: "A jeni dakord me vendimin nr.67 datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak, për ndërtimin me koncesion të një parkimi nëntokësor tek Parku Rinia?", dhe paisjen me Fletën-Tip, për mbledhjen e nënshkrimeve.

2. Fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë, në lidhje me çështjen: "A jeni dakord që brenda Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë, në të dy anët e Korpusit të Universitetit Politeknik, të ndërtohen objekte, qofshin këto edhe social-kulturore, universitare apo administrative?", dhe paisjen me Fletën-Tip për mbledhjen e nënshkrimeve.

3. Fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, për çështjen e qeverisjes vendore të Bashkisë Tiranë. "A jeni dakord që të ndërtohet kënd lojrash duke betonizuar zemrën e Parkut të Liqenit në Bashkinë Tiranë?", dhe paisjen me Fletën-Tip për mbledhjen e nënshkrimeve.

4. Fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi vendor, për disa çështje në lidhje me zonat e mbrojtura të Bashkisë Tiranë, dhe paisjen me Fletën-Tip për mbledhjen e nënshkrimeve.

5. Fillimin e procedurave për zhvillimin e një referendumi në Bashkinë Tiranë, për disa çështje në lidhje me lejet e zhvillimit dhe ndërtimit në territorin e Bashkisë Tiranë, dhe paisjen me Fletën-Tip për mbledhjen e nënshkrimeve.

KQZ ka shqyrtuar brenda aftit të përcaktuar, në pjesën e nëntë "Referendumet", të ligjit nr.9087, datë 19.06.2013 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të pesë kërkesat e mësipërme, të paraqitura nga grupet e nismëtarëve.

KQZ shqyrtoi kërkesat e nismëtarëve në drejtime, si: lloji i referendumit për të cilin kërkohet fillimi i procedurave (i përgjithshëm apo vendor); ekzistencën dhe qartësinë e çështjes që shtrohet për referendum, rëndësia e saj, kufizimet në ushtrimin e të drejtës për referendum, përveç se, edhe aspekte të tjera ligjore, që do të gjejnë pasqyrim në fletën-tip për mbledhjen e nënshkrimeve, e cila përpilohet nga vetë Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve. Duke i vlerësuar këto kërkesa, në raport me rregullat ligjore, përpara mbledhjes së nënshkrimeve të nevojshme për të kërkuar fillimin e procedurave për zhvillimin e referendumit, rregulla të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur, në radhë të parë nga nismëtarët, KQZ, si organi më i parë që kontrollon ligjshmërinë e kërkesës, vendosi rrëzimin e kërkesave rast pas rasti për pajisjen me fletë-tip, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për zhvillimin e referendumeve vendore të propozuara.

Grupet e nismëtarëve i kanë kundërshtuar vendimet e sipërcituara në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe në të gjitha rastet, Kolegji Zgjedhor, ka vendosur rrëzimin e tyre dhe lënien në fuqi të vendimit të KQZ-së, si vendim i nxjerrë në

mbështetje të plotë me pjesën e nëntë "Referendumet", të ligjit nr.9087, datë 19.06.2013, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

III. PLOTËSIMI I VAKANCAVE TË NJOFTUARA NGA KUVENDI

Për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim, në zbatim të Nenit 164 të Kodit Zgjedhor. Ky nen përcakton, se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës, dhe KQZ merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës, në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Gjatë vitit 2016, KQZ ka bërë dy zëvendësime vakancash të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë, për shkak të ndërprerjes së mandatit të deputetëve Koço Kokëdhima (Qarku Vlorë) dhe Sherefedin Shehu (Qarku Dibër). Në rastin e parë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me **vendimin nr.58, datë 10.06.2016**, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës, në listën shumemërore të Partisë Socialiste Qarku Vlorë, z.Edmond Dhimitraq Leka, për shkak të mbarimit të mandatit të deputetit Z.Koço Kokodhëma, në kuadër të plotësimit të vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë për këtë qark. Ndërkohë, që me **vendimin nr.108, datë 16.08.2016**, KQZ-ja, ka vendosur t'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmërore të Partisë Demokratike Qarku Dibër, zj.Dhurata Çupi, për shkak të mbarimit të mandatit të deputetit të Z.Sherfedin Shehu, të njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Në të dy rastet kandidatët kanë paraqitur në KQZ formularët e vetëdeklarimit, të cilët janë plotësuar e verifikuar në bazë të përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015".

IV. TRAJNIME TË PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE PËR ADMINISTRIMIN ZGJEDHOR JASHTË PERIUdhËS ZGJEDHORE PËR PERSONA TË INTERESUAR

KQZ-ja gjatë vitit 2016, ka synuar konsolidimin e veprimtarive për zhvillimin e trajnimeve të përgjithshme, si dhe për funksione të veçanta të administrimit zgjedhor. Veprimtaria ka fokusuar, në mënyrë të integruar dy drejtime:

1. Realizimin e sesioneve të trajnimit të përgjithshëm, dhe për funksione të veçanta të administrimit zgjedhor, si përmbushje të detyrimit përcaktuar në nenin 21, pika 10, të Kodit Zgjedhor;

2. Vendosjen në funksionim të Qendrës së Trajnimeve Zgjedhore, me mbështetjen e donatorëve, partnerë të KQZ-së, hartimin e programeve të trajnimit dhe nisjen e ciklit të parë të trajnimeve për vitin 2016, si zbatim i rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë përmes "Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015".

Ekspierenca e KQZ-së për realizimin e trajnimeve zgjedhore, si për komisionerët zgjedhorë, ashtu edhe për personat e interesuar në periudhë jashtë zgjedhore , e mbështetur nga partnerët ndërkombëtarë është cënuar nga probleme të natyrave të ndryshme, ku më kryesoret janë:

- Cilësia dhe shtrirja e trajnimeve, e lidhur me burimet njerëzore dhe financiare të pamjaftueshme institucionale;
- Mungesa e dispozitave ligjore për të lidhur trajnimin zgjedhor, testimin dhe certifikimin paraprak nga KQZ-ja, si kusht për t'u emëruar komisioner zgjedhor, e cila kushtëzon interesin për pjesëmarrje në sesione trajnimi në periudhë jashtëzgjedhore .

KQZ-ja, përmes dokumentit "Përmirësimi i trajnimit zgjedhor të KQZ-së", hartuar me mbështetje të Zyrës së KE-së, në janar 2016, i ka paraqitur Kuvendit të Shqipërisë nevojat për realizimin e trajnimit dhe edukimit zgjedhor përmes një mekanizmi të qëndrueshëm. KQZ-ja ka propozuar tre mundësi për funksionimin e Qendrës së Trajnimeve: (1) qendër trajnimi e pavarur, (2) qendër autonome me mbikqyrje të KQZ-së dhe (3) forcimi i strukturës ekzistuese në KQZ. Dy propozimet e para do të kërkonin ndryshime ligjore. Propozimi i tretë, synonte krijimin e një strukture administrative, pjesë të administratës së KQZ-së, për të realizuar funksionet e një Qendre Trajnimi dhe Edukimi Zgjedhor. Gjatë vitit 2016, këto propozime mbetën pa përgjigje, qoftë propozimi i tretë, i cili do do kërkonte vetëm shtim të burimeve njerëzore, për të fuqizuar strukturën aktuale të trajnimeve të KQZ-së e cila përbëhet vetëm nga dy nëpunës civilë.

IV.1 Bashkërendimi i punës me partnerët ndërkombëtarë për vënien në funksionim të Qendrës së Trajnimeve Zgjedhore:

Puna e KQZ-së për të vënë në funksionim Qendrën e Trajnimit Zgjedhor, u mbështet nga Këshilli i Evropës dhe prania e OSBE-së, si një vijim i përpjekjeve të koordinuara disavjeçare për krijimin e një platforme të përhershme trajnimi dhe edukimi zgjedhor, me synim rritjen e profesionalizmit të administratës zgjedhore dhe të shumë aktorëve të tjerë me rol në procesin zgjedhor.

Hartimi i kurikulave të reja të trajnimit, përmirësimi i tyre me metoda dhe metodologji bashkëkohore, duke ofruar qasje proaktive përmes kombinimit të teorisë me praktikën, kërkon pikë së pari, identifikimin e nevojave të zgjedhësve në përgjithësi, dhe specifikisht të grupimeve me rol të drejtpërdrejtë apo qasje specifike me procesin

zgjedhor. Gjetjet e KQZ-së, për të identifikuar nevojat për informacion zgjedhor, përmes anketimeve të nisura qysh në 2014, u synuan të plotësohen përmes një projekti të realizuar nga prania e OSBE-së me mbështetjen e Ambasadës Zviceriane. Akademia e Studimeve Politike, përmes intervistave dhe pyetsorëve të zhvilluar në qarqet Tiranë, Shkodër, Fier dhe Gjirokastër, mblodhi informacionin e nevojshëm mbi bazën e të cilit, do të analizohet situata nga ekspertë zgjedhorë, me qëllim hartimin e kurikulave për trajnimin zgjedhor të përgjithshëm dhe për funksione të veçanta të administrimit zgjedhor. Vëzhguesit vendorë, komisionerët zgjedhorë, votuesit e rinj, gratë, personat me aftësi të kufizuar, pakicat kombëtare dhe minoritetet etno-gjuhësore: romët dhe egjiptianët, ishin grupet e fokusuara të këtij studimi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në ndërtesën ku u akomodua në janar të vitit 2016, disponon ambiente të veçanta për realizimin e veprimtarive për trajnim dhe edukim zgjedhor të shtetasve të interesuar për çështje zgjedhore, të padisponueshme më parë. Këshilli i Evropës, mbi bazën e nevojave të paraqitura nga KQZ-ja, ka marrë përsipër të kompletojë këto ambiente me pajisje logjistike bashkëkohore, të cilat padyshim do të përmirësojnë cilësinë e trajnimeve zgjedhore, dhe do të rrisin numrin e të interesuarve për të marrë pjesë në sesionet e trajnimit zgjedhor.

IV.2 Realizimi i sesioneve të trajnimit të përgjithshëm dhe për funksione të veçanta të administrimit zgjedhor.

Në maj 2016, u zhvillua në bashkëpunim me praninë e OSCE-së (OSBE-së) në Shqipëri, një sesion dy ditor trajnimi zgjedhor. Në këtë veprimtari, që shënoi pikënisjen e veprimtarive trajnuese të KQZ-së në ambientet e reja, morën pjesë dhe ekspertë ndërkombëtarë në çështjet e trajnimit zgjedhor. Në këtë sesion dy ditor trajnimi morën pjesë trajnues të KQZ-së dhe të rinj studentë të interesuar për njohuri në çështjet zgjedhore. Me module të veçanta u trajtuan aspektet më të rëndësishme të administrimit zgjedhor. Gjithashtu, u prezantua Manuali "Edukimi demokratik qytetar, dhe edukimi i votuesve", hartuar nga ekspertë zgjedhorë të OSBE-së në bashkëpunim me KQZ-në. Ky Manual jo vetëm do t'i shërbejë trajnerëve në punën e tyre, por do të ketë vlerë për çdo përdorues, pasi trajton aspekte të ndryshme të administrimit zgjedhor në kontekst të parimeve demokratike që garantojnë zgjedhjet e lira të drejta dhe demokratike.

KQZ-ja asistoi me ekspertizë dhe logjistikë zgjedhore proceset zgjedhore që u zhvilluan në Universitet e vendit përgjatë vitit 2016. Rregullat për mënyrën e organizimit dhe administrimit të këtyre proceseve zgjedhore, rregullat për funksionimin dhe punën e administratës zgjedhore që organizoi dhe administroi këto procese, ishin pothuaj të njëjta me ato të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Këta faktorë bënë që trajnimi i anëtarëve të komisioneve zgjedhore, që u ngritën dhe funksionuan për zgjedhjet në Universitete, të ishte nga veprimtaritë më efikase që KQZ-ja ndërmori për trajnimin zgjedhor jashtë periudhes zgjedhore. Nga kjo veprimtari e KQZ-së përfituan të rinj dhe

pedagogë të angazhuar si komisionerë zgjedhorë të të gjitha niveleve, si vëzhgues apo dhe vetë kandidatët.

KQZ-ja asistoi gjatë vitit 2016 zgjedhjet në shkolla të mesme të vendit për "Qeverinë e Nxënësve", zgjedhjet në Universitete për "Qeverinë e Studentëve" si dhe për Parlamentin Rinor të Qarkut Fier, ku sesionet e trajnimit realizuan qëllimin për të transmetuar njohuri të përgjithshme dhe për funksione të veçanta të administrimit zgjedhor.

Vlerësimi i rektorateve të Universiteteve, i Drejtorive të Shkollave të Mesme se *"Mbështetja e KQZ-së siguroi për të gjithë studentët realizimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike, për të mbrojtur integritetin dhe fshehtësinë e votës, duke kontribuar në konsolidimin e demokracisë në procesin zgjedhor si votues të ardhshëm"*, është treguesi më domethënës për rëndësinë e veprimtarive trajnuese zgjedhore jashtë periudhës zgjedhore.

V. ORGANIZIMI I PROGRAMEVE PËR EDUKIMIN ZGJEDHOR TË SHTETASVE JASHTË PERIUDHËS ZGJEDHORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përmbushje të misionit të tij për edukimin zgjedhor të shtetasve, tregon vëmendje të veçantë për hartimin dhe realizimin e programeve edukuese për zgjedhësit në përgjithësi, dhe programe edukuese specifike për grupime shoqërore të caktuara.

Përgjatë vitit 2016, hartimi dhe zbatimi i programeve edukuese zgjedhore referoi edhe në:

- Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së KQZ-së për vitin 2015", ku kërkohej fokusimi në *vazhdimin e hartimit të programeve dhe projekteve të posaçme për pakicat kombëtare me programe informimi, edukimi dhe përfshirjen e përfaqësuesve të pakicave në trajtimin e çështjeve zgjedhore, përgjatë vitit në vazhdim deri në zgjedhjet e radhës;*
- Raportin përfundimtar të OSBE/ODHIR-it për zgjedhjet vendore 2015, i cili rekomandonte *"KQZ-ja dhe palët e tjera mund të organizojnë programe edukuese gjithëpërfshirëse në formën e takimeve me zgjedhësit, të përshtatura për nevojat e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane"*.

Celebrimi i Ditës Botërore të Zgjedhjeve, është një nga veprimtaritë më të rëndësishme për edukimin zgjedhor. KQZ-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Institutin e Kulturës Rome (IRCA), në 5 shkurt 2016, organizoi në ambientet e qendrës rinore "Tirana", veprimtari të ndryshme për celebrimin e kësaj Dite.

Të rinj të shkollave të mesme të kryeqytetit, studentë, të rinj me aftësi ndryshe dhe të rinj romë, morën pjesë në aktivitete që synonin sensibilizimin për rëndësinë, vlerën dhe forcën e votës në proceset demokratike të vendit. Duke vënë theksin te ndërgjegjia dhe përgjegjësia qytetare, si faktori kryesor për rritjen e standardeve të procesit zgjedhor,

me të rinjtë u bashkëbisedua për rëndësinë e përfshirjes dhe kontributit që ata mund të japin me pastërtinë e mendimeve, energjinë dhe forcën rinore, për t'u bërë barriera të pakapërcyeshme për fenomenet negative që çenojnë votën e lirë.

Në simbolikën e kësaj dite, KQZ-ja materializoi bashkëpunimin me Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi, me synimin e zhvillimit gjatë vitit 2016 të projekteve edukuese zgjedhore specifike për komunitetet Rome.

Me moton "Për Romët, me Romët", në bashkëpunim me IRCA-n, u hartuan dhe u vunë në zbatim programe edukuese zgjedhore për komunitetet rome dhe egjiptiane. Metodologjia, format dhe mjetet e përdorura, u bazuan në specifikat sociale, nivelin kulturor dhe arsimor të komuniteteve.

Mbështetja e pranisë së OSBE-së, mundësoi që këto programe, të zbatohen si një Projekt Edukues për komunitetin, në të gjitha vendqëndrimet: Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Kuçovë, Pogradec, Korçë, Gjirokastër, Lezhë, Delvinë, dhe të shtrihet në kohë duke garantuar qëndrueshmërinë e veprimtarisë.

KQZ-ja përmes realizimit të këtij projekti synon:

- forcimin e kulturës zgjedhore të komunitetit rom dhe egjiptian ndërgjegjësimin për rëndësinë e procesit të votimit si pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse të vendit;
- ndërgjegjësimin për fenomenin negativ të shitblerjes së votës , me synim parandalimin e tij;
- të "thyejë" mendësinë e përjashtimit dhe mosbesimit në ndryshim me forcën e votës;
- fuqizimin e komunitetit për të mbrojtur liritë dhe të drejtat në zgjedhje, përmes mënyrave dhe mjeteve që realizojnë adresimin në kohën dhe vendin e duhur të problemeve që prekin Romët në procesin zgjedhor;
- të sigurojë rolin aktiv të të rinjve dhe grave rome në procesin zgjedhor, si zgjedhës, apo të angazhuar në veprimtari administrative për çështje lidhur me organizimin/administrimin e procesit zgjedhor (trajnerë, nëpunës të përkohshëm të KQZ-së, vëzhgues etj).

Faza e parë e projektit konsistoi në trajnimin e 30 studentëve romë nga të gjitha qarqet e vendit me njohuri për procesin zgjedhor, për procedurat e votimit, si dhe në zhvillimin e aftësive prezantuese dhe komunikuese të tyre në komunitet.

Gjatë fazës së dytë të projektit, të rinj rom të trajnuar do të zhvillojnë sesione edukimi zgjedhor në komunitet në 11 vendqëndrime të vendit: Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Berat, Kuçovë, Pogradec, Korçë, Gjirokastër, Lezhë, Delvinë. Modulet e hartuara për këto sesione, janë konceptuar për të përcjellë mesazhet dhe njohuritë zgjedhore në formën e bashkëbisedimit. Simulimi i procesit të votimit zhvillohet në mbyllje të sesionit, për të qartësuar procedurat që ndiqen në qendrën e votimit për anëtarët e komunitetit.

Sesionet e edukimit realizohen në shkolla, në kuadër të nismës "Shkolla, qendër komunitare".

KQZ-ja, përmes këtij projekti, synon edhe kontributin institucional për integrimin e rinisë Rome, si një formë edukimi në vetvete për ndryshimin e mentaliteteve diskriminuese.

Faza e tretë e projektit, që do të zbatohet në qershor 2017, synon dhënien e asistencës konkrete për probleme që komuniteti rom has në zgjedhje, përfshirë këtu edhe tentativa për blerjen e votës. Të rinjtë romë të trajnuar nga KQZ-ja do të shërbejnë si "zyrë" zgjedhore për komunitetin në muajin qershor, me qëllim që komuniteti të referojë problematikat pa ndjesi inferioriteti për shkak të vështirësive në të artikuluar apo paqartësisë se ku duhet të adresojë problemin.

Gjatë vitit 2016 u realizuan botime të ndryshme në funksion të edukimit të shtetasve për çështje zgjedhore si: "Barazia Gjinore në proceset zgjedhore në Shqipëri", "Kontrolli i financave të partive politike në vit kalendarik dhe fushatë zgjedhore", "Historiku i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve". U publikua fletëpalosje me informacion për problematikat e personave me aftësi ndryshe në procesin zgjedhor dhe angazhimi i KQZ-së për minimizimin e tyre. Përmes publikimit të një fletëpalosjeje tjetër u dha informacion për projektet edukuese zgjedhore që KQZ-ja zbaton për pakicat kombëtare. Këto materiale të botuara edhe në anglisht, së bashku me botime të tjera dhe me materiale të ndryshme filmike, të prodhuara nga KQZ-ja, u ekspozuan në një stendë të veçantë gjatë punimeve të Konferencës së 25-të të ACEEEO-s, shtator 2016. Pjesëmarrësit në Konferencë, vlerësuan plotësinë e informacionit dhe punën e KQZ-së për edukimin zgjedhor të shtetasve.

Veprimtari të veçanta u zhvilluan për edukimin zgjedhor me zgjedhësit e Bashkisë Dibër, shtator 2016, dhe zgjedhësit e Bashkisë Kolonjë, nëntor 2016. Për të dy këto procese të pjesshme zgjedhore, u prodhuan postera informues për procedurat e votimit, ndërgjegjësues për veprimet e ndaluara në qendrën e votimit, sensibilizues për rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje që adresonin të gjithë grupimet shoqërore: të rinjtë, gratë, të moshuarit dhe personat me aftësi ndryshe. Çdo qendër votimi u pajis me këto postera. Informacion i plotë për procesin zgjedhor, të drejtat dhe detyrat e zgjedhësit, fenomenet negative që çënojnë standartet e procesit, kundërvajtjet administrative dhe veprat penale në zgjedhje, u shpërndanë përmes fletëpalosjeve për zgjedhësit në të dy këto Bashki. Mesazhe informuese, ndërgjegjësuese, dhe sensibilizuese për pjesëmarrje në votime u transmetuan për të dy këto procese të pjesshme zgjedhore në Televizionin Shqiptar. Lidhur me zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, të gjithë materialet për edukim zgjedhor u prodhuan edhe në gjuhën maqedonase, dhe u shpërndanë për zgjedhësit që i përkasin kësaj pakice kombëtare.

Lidhur me zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, u realizuan takime me votuese gra në qytetin e Peshkopisë, dhe në njësitë administrative Maqellarë dhe Muhurr. Në takime morrën pjesë një numër i madh i votuesesh gra, edhe nga zona të thella si: Melan,

Sllovë, Arras, etj., falë mbështetjes së veprimtarive nga prania e OSBE-së. Çështjet e barazisë gjinore në procesin zgjedhor, si tregues domethënës për përfshirjen e gruas në vendimmarrje, forcimi i kuotave gjinore për zgjedhjen e këshillave vendorë, ishin kryetema e diskutimeve në këto takime. Gratë pjesëmarrëse diskutuan dhe ndanë eksperiencat e tyre si votuese, komisionere apo anëtare të këshillit bashkiak.

Lidhur me zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kolonjë, u realizua takim me votuesit e rinj, me të cilët Kryetari i KQZ-së bashkëbisedoi për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje, votimin në mënyrë të pandikuar, si detyrim ligjor dhe si përgjegjësi qytetare.

VI. ORGANIZIMI I ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË DIBËR DHE KOLONJË.

VI.1 Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Dibër, 11 shtator 2016

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, menjëherë pas dekretimit nga Presidenti i Republikës të datës për zhvillimin e zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Dibër, miratoi planin e veprimit, një udhërfyese ky për kohën e miratimit të akteve të nevojshme nënligjore, për organizim dhe administrim të këtij procesi të pjesshëm zgjedhor.

KQZ-ja miratoi 58 vendime, të natyrës organizative dhe ekzekutuese, përmes të cilave :

- Miratoi afatet procedurale për procesin e pjesshëm zgjedhor për Kryetarin e Bashkisë Dibër;
- Rregjistroi si subjekte zgjedhore 25 parti politike, dhe dy koalicione;
- Caktoi partitë politike që do të propozonin anëtarët e KZAZ-së nr.19;
- Emëroi Kryetarin, Zv. Kryetarin, anëtarët dhe sekretarin e KZAZ 19
- Miratoi dokumentacionin e punës që do të përdorej nga KZAZ-të dhe KQV-të;
- Miratoi dokumentacionin e kandidimit;
- Miratoi caktimin e 10 Qendrave të Votimit në Ambiente private;
- Caktoi vendndodhjen e Vendit të Numërimit të Votave;
- Miratoi përmbajtjen e fletës së votimit me dy kandidatë për kryetar bashkie;
- Miratoi sasinë e fletëve të votimit;
- Miratoi përdorimin e kamerave regjistruese dhe bazën materiale zgjedhore që do të përdorej;
- Miratoi akreditimin e 117 vëzhguesve afatshkurtër dhe afatgjatë, të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, të KZLNDQ-së, të Shoqërisë Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, të Ambasadës Suedeze, të Bashkimit Evropian dhe të Ambasadës Amerikane;
- Shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

VI.1.1 Administrata zgjedhore e nivelit të dytë dhe të tretë

KQZ-ja, më datë 11 gusht 2016, emëroi anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr.19. KZAZ-ja nr.19 u krijua më datë 12 Gusht 2016, dhe po këtë ditë KQZ-ja emëroi Kryetarin dhe Sekretarin e KZAZ-së nr.19.

Menjëherë pas krijimit , anëtarët e KZAZ-së nr.19 u trajnuan për përmbushjen korrekte të detyrave dhe përgjegjësive, dhe përgjithësisht dëshmuan profesionalizëm dhe përgjegjshmëri gjatë periudhës së funksionimit:

- regjistruan në afat kandidatët për Kryetar të Bashkisë Dibër të propozuar nga dy koalicionet zgjedhore të regjistruara në KQZ;
- emëruan brenda afatit ligjor anëtarët e 118 KQV-ve, sipas propozimeve të partive politike;
KQZ-ja, ndërtoi bazën e të dhenave për 826 komisionerët e 118 QV-ve, nga të cilët 812 ose 98.3% ishin meshkuj, dhe vetëm 14 ose 1.7% ishin gra.
- caktoi ngritjen e 16 Grupeve të Numërimit të Votave (GNV);
Partitë politike nuk respektuan afatin ligjor për propozimet e 64 anëtarëve të GNV-ve.
- akreditoi 300 vëzhgues të subjekteve zgjedhore për të vëzhguar procesin zgjedhor në KQV dhe VNV;
- emëroi anëtarët e GNV-ve përpara fillimit të procesit të numërimit të votave, për shkak të propozimeve të vonuara të partive politike.

VI.1.2 Trajnimi i komisionerëve të Qendrave të Votimit dhe anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave

KQZ-ja hartoi dhe prodhoi Manuale për trajnimin e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve, duke qartësuar detyrat dhe procedurat që do të përmbushnin këto komisione zgjedhore.

Skema e trajnimit për KQV-të dhe GNV-të, e cila iu njoftua partive politike dhe u publikua edhe në faqen zyrtare të KQZ-së, krijonte kushte optimale për pjesëmarrje të komisionerëve në sesionet e trajnimit të organizuar nga KQZ-ja. Sesionet e trajnimit ofroheshin paradite dhe pasdite në datat 7-9 shtator 2016, duke përfshirë 15 njësitë administrative të Bashkisë Dibër, me qëllim shmangien e pengesave për pjesëmarrje. Në njësitë administrative të largëta, sesionet e trajnimit u ofruan në fshatrat-qendër.

Pavarësisht këtyre masave, pjesëmarrja e komisionerëve në sesionet e trajnimit ishte shumë e ulët. Në sesionet e trajnimit morrën pjesë rreth 100 komisionerë të qendrave të votimit, vetëm në qytetin e Peshkopisë dhe Maqellarë. Në njësitë administrative si Muhurr, Zall Dardhë, Zall-Reç, Kala e Dodës nuk u paraqit asnjë komisioner.

KQZ-ja, duke vlerësuar rëndësinë e trajnimit zgjedhor për garantimin e miradministrimit të procesit, bëri thirrje në mënyrë të vazhdueshme për partitë politike dhe komisionerët e emëruar, por situata nuk pati ndryshime. KQZ-ja, që nuk përballej së pari me këtë

situatë, kishte marrë masat dhe kreu trajnimin e komisionerëve të KQV-ve që u paraqitën për të tërhequr bazën materiale zgjedhore ditën e shtunë pranë KZAZ-ve.

Trajnimi i GNV-ve, pavarësisht planifikimit dhe njoftimeve, u zhvillua vetëm përpara fillimit të procesit të numërimit të votave, për shkak të emërimeve të vonuara të tyre.

VI.1.3 Lirimi, zëvendësimet e anëtarëve të KQV-ve

Një ditë para zgjedhjeve dhe mëngjesin e ditës së zgjedhjeve ndryshoi përbërja e 98% të komisioneve të Qendrave të Votimit, fakt i cili dëshmoi sërish sjelljen jo në respekt të ligjit zgjedhor të partive politike. Konkretisht:

- Nga 118 kryetarë të KQV-ve, u zëvendësuan 49 ose 41.6 % prej tyre;
- Nga 118 sekretarë të KQV-ve, u zëvendësuan 63 ose 53.3 % prej tyre;
- Nga 590 anëtarë të KQV-ve, u zëvendësuan 276 ose 46.7 % prej tyre.

VI.1.4 Shpërndarja e bazës materialeve zgjedhore nga KZAZ-të në KQV

KQZ-ja dërgoi më datë 8.09.2016 në KZAZ-te nr.19 bazën materiale zgjedhore për procesin e votimit dhe numërimit të votave.

Shpërndarja e bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-te për KQV-të përfundoi rreth orës 22:00, të ditës së shtunë datë 10.09.2016, në tejkalim të afatit ligjor.

VI.1.5 DITA E ZGJEDHJEVE

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe procesi u zhvillua në mënyrë të rregullt. Në të gjitha QV-të, votimi filloi në orën 7:00. Stafi i KQZ-së, i angazhuar për të monitoruar nga afër procesin e votimit, së bashku me anëtarët e KZAZ-së 19, inspektoi gjatë gjithë ditës qendra të ndryshme votimi, me prioritet ato QV për të cilat njoftoheshin problematika. Problemet kishin shkak mungesën e profesionalizmit të komisionerëve, dhe nuk cënuan në asnjë rast ecurinë e procesit:

- humbja e vulës së KQV-së (QV nr.1167, Arras, fshati Cidhën). Procedura e zëvendësimit të vulës u krye menjëherë, sipas vendimit të KQZ-së.
- mbyllja e kutisë së votimit me kapakun e kutisë së materialeve zgjedhore;
- mostimbrimi i zgjedhësit nga KQV-ja, me justifikimin "ne i njohim zgjedhësit..., i fyejmë ata nëpërmjet timbrimit";
- kutia e votimit në një QV, e dëmtuar në masë të vogël u zëvendësua menjëherë me kuti rezervë të votimit;
- raste të fotografimit të votës u njoftuan në dy QV-të, të cilat u inspektuan menjëherë dhe u udhëzuan komisionerët si të vepronin për ta shmangur këtë fenomen.

Nga ana e KQZ-së u morrën masa që gjatë ditës së votimit të informohej publiku çdo tre orë për pjesmarrjen në votim sipas njësive administrative. Pjesmarrja në votim, në rang bashkie ishte 59,05 %, e femrave 57,78 %.

VI.1.6 Mbyllja e votimit dhe dorëzimi i materialeve të votimit nga KQV-të në VNV

Të gjitha QV-të u mbyllën në orën 19-00. Dorëzimi i materialeve të votimit nga KQV-të në VNV përfundoi në orën 22-00 të ditës së zgjedhjeve. Të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit u dorëzuan të rregullta.

VI.1.7 Procesi i numërimit të votave

Vendi i Numërimit të Votave, u përgatit dhe organizua për kryerjen e procesit të numërimit në kushte optimale. Numërimi filloi menjëherë pas përfundimit të trajnimit të anëtarëve të GNV-ve, shkoi përgjithësisht i qetë, me rregull dhe qetësi. KZAZ-ja kërkoi ndihmën e Policisë së Shtetit vetëm në një rast për të larguar nga VNV personat e paautorizuar.

Vendosja e 8 tavolinave të numërimit, ku numëruan njëherazi 8 GNV, shtuar këtu dhe faktin që u numëruan vetëm kutitë e votimit për kryetarin e Bashkisë, krijoi kushtet që numërimi të përfundojë përpara afatit ligjor, në orën 18-00 të datës 12 shtator 2016. Publiku u informua për rezultatin paraprak të zgjedhjeve në faqen e internetit të KQZ-së, në dinamikë, duke filluar nga numërimi i kutisë së parë deri te ajo e fundit.

VI.2 Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kolonjë, 20 nëntor 2016

Pas dekretimit nga Presidenti i Republikës së datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kolonjë, KQZ-ja menjëherë miratoi planin e veprimit, një udhërefyes për kohën e miratimit të akteve të nevojshme nënligjore për organizim dhe administrim të këtij procesi të pjesshëm zgjedhor. Për këtë proces zgjedhor, KQZ-ja miratoi 40 akte, përmes të cilave:

- Miratoi afatet proceduriale për procesin e pjesshëm zgjedhor për Kryetarin e Bashkisë Kolonjë;
- Rregjistroi si subjekte zgjedhore 17 parti politike dhe dy koalicione;
- Caktoi partitë politike që do të propozonin anëtarët e KZAZ-së nr.73;
- Emëroi Kryetarin, Zv. Kryetarin, anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr.73;
- Miratoi dokumentacionin e punës që do të përdorej nga KZAZ-të dhe KQV-të;
- Miratoi dokumentacionin e kandidimit;
- Caktoi vendodhjen e Vedit të Numërimit të Votave;
- Miratoi përmbajtjen e fletës së votimit me dy kandidatë për kryetar bashkie;
- Miratoi sasinë e fletëve të votimit për çdo QV;
- Miratoi përdorimin e kamerave regjistruese dhe bazën materiale zgjedhore që do të përdorej;
- Miratoi akreditimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe afatgjatë, të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë dhe të Bashkimit Europian;
- Shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

VI.2.1 Administrata zgjedhore e nivelit të dytë dhe të tretë

KQZ-ja emëroi anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr.73, më datë 22.10.2016. KZAZ-ja nr.73 filloi punën më datë 22.10.2016, dhe gjatë gjithë kohës së funksionimit dëshmoi korrektësi dhe profesionalizëm në përmbushjen e detyrave:

- regjistruan në afat kandidatët për Kryetar të Bashkisë Kolonjë, të propozuar nga dy koalicionet zgjedhore të regjistruara në KQZ;
- emëroi në afat anëtarët e 36 Komisioneve të Qendrave të Votimit;
Partitë politike dorëzuan në afat propozimet dhe dokumentacionin përkatës. Pati një numër të vogël zëvendësimesh të anëtarëve të KQV-ve.
- caktoi në afat numrin e grupeve të numërimit të votave, por emërimi i anëtarëve të tyre u bë vetëm përpara fillimit të procesit të numërimit për shkak të propozimeve të vonuara të partive politike.

VI.2.2 Trajnimi i komisionerëve të Qendrave të Votimit dhe anëtarëve të Grupeve të Numërimit të Votave

KQZ-ja hartoi dhe prodhoi Manuale për trajnimin e anëtarëve të KQV-ve dhe GNV-ve, duke qartësuar detyrat dhe procedurat që do të përmbushnin këto komisione zgjedhore. Skema e trajnimit për KQV dhe GNV, e cila iu bë me dije partive politike dhe u publikua edhe në faqen zyrtare të KQZ-së, krijonte kushte optimale për pjesëmarrje të komisionerëve në sesionet e trajnimit të organizuar nga KQZ-ja. Sesionet e trajnimit u bënë në datat 16-18 nëntor 2016, në qytetin e Ersekës dhe në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Kolonjë.

Në sesionet e trajnimit morrën pjesë 116 komisionerë ose 46 % e numrit të përgjithshëm, kryesisht të propozuarit nga partitë e shumicës parlamentare.

Ditën e shtunë, më datë 19 nëntor 2016, u zhvillua një trajnim specifik me Kryetarët dhe Sekretarët e QV që u paraqitën në KZAZ për të marrë në dorëzim bazën materiale zgjedhore.

VI.2.3 Shpërndarja e bazës materialeve zgjedhore nga KZAZ në KQV

KQZ-ja dërgoi më datën 17 nëntor 2016 në KZAZ nr.73 bazën materiale zgjedhore për procesin e votimit dhe numërimit të votave.

Shpërndarja e bazës materiale zgjedhore nga KZAZ për KQV-të përfundoi rreth orës 20-00 të ditës së shtunë.

VI.2.4 DITA E ZGJEDHJEVE

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë dhe procesi u zhvillua në të gjitha QV-të në mënyrë të rregullt. Vetëm në dy QV, për shkak të debateve të komisionerëve, u ndërpre votimi për rreth dy orë. Shkak për debat u bë prania e disa personave në ambientet jashtë Qendrave të Votimit. KZAZ-ja nr.73, menaxhoi situatën në mënyrë korrekte, inspektoi QV-të, dha asistencën e duhur për komisionerët, si dhe njoftoi partitë politike

për të dërguar propozimet përkatëse n.q.s do të ndodhte që komisionerë të caktuar do të braktisnin detyrën.

Qendrat e votimit u mbyllën në orën 18-00, dhe dorëzimi i materialeve të votimit nga KQV-të në VNV përfundoi në orën 19-45. Të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit u dorëzuan të rregullta. Nga ana e KQZ-së u morrën masa, që gjatë ditës së votimit, të informohej publiku çdo tre orë, për pjesëmarrjen në votim sipas njësive administrative. Pjesëmarrja në votim në rang bashkie, ishte 52,36 %, e femrave 43,78 %.

VI.2.5 Procesi i Numërimit të Votave

Procesi i numërimit të votave filloi rreth orës 24-00, pasi u trajnuan anëtarët e grupeve të numërimit. Në VNV nuk pati prani të personave të paautorizuar, numërimi vazhdoi i qetë, pa asnjë incident, dhe përfundoi rreth orës 16-00 të datës 21.11.2016. Publiku u informua për rezultatin paraprak të zgjedhjeve në faqen e internetit të KQZ-së, në dinamikë, duke filluar nga numërimi i kutisë së parë deri te ajo e fundit.

VII. VEPRIMTARIA E KQZ-SË PËR PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN 2017

VII.1. Përgatitja e infrastrukturës zgjedhore.

Caktimi i ambienteve të punës së KZAZ-ve, ambienteve të Zyrave Rajonale Zgjedhore, ndarja apo bashkimi i qendrave të votimit, caktimi i vendndodhjes së qendrave të votimit, propozimi i Vendeve të Numërimit të Votave, angazhon aktorë të ndryshëm të ndërveprojnë me KQZ-në. Përvoja ka dëshmuar se përmbushja e detyrimeve ligjore për përgatitjen e infrastrukturës së objekteve që përdoren për qëllime zgjedhore, është shoqëruar me problematika, zgjidhja e të cilave është realizuar në tejkalim të afateve ligjore, duke investuar dhe angazhuar KQZ-në në vijimësi, në një periudhë kur probleme më të rëndësishme të procesit zgjedhor kërkojnë vemendje dhe vendimmarrje institucionale.

KQZ-ja, ka vlerësuar se praktikat e ndjekura në zgjedhjet e mëparshme nëpërmjet adresimit shkresor për Kryetarët e Bashkive, menjëherë pas caktimit të datës së zgjedhjeve, për të qartësuar detyrimet ligjore, mënyrën e përmbushjes korrekte dhe në afat të tyre, kanë qënë të pamjaftueshme për organizimin dhe administrimin e duhur të këtyre çështjeve. Për të përmirësuar këtë proces, KQZ-ja ndërmori qysh në fillim të vitit 2016, projektin "Përgatitja e infrastrukturës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend 2017".

Ky projekt u hartua dhe zbatua në ushtrim të kompetencës së KQZ-së për të drejtuar dhe kontrolluar kolegjisht, nëpërmjet çdo anëtari ose strukturave të saj, procesin parazgjedhor. Kjo qasje e re në mënyrën e organizimit dhe administrimit të fazës parazgjedhore të procesit zgjedhor, synoi forcimin e bashkëpunimit, dhe diskutimin e

drejtpërdrejtë të problematikave. KQZ-ja vuri në dispozicion të Kryetarëve të Bashkive dhe Prefektëve të Qarqeve, materiale me të dhëna të plota për objektet zgjedhore brenda territoreve përkatëse, vendndodhja apo kushtet e të cilave kishte paraqitur problematikë në zgjedhjet e fundit.

Në takime me Kryetarët e Bashkive dhe Prefektët e Qarqeve, problemet u diskutuan në nivel partneriteti, duke kërkuar marrjen e masave në kohë për eliminimin e problematikave për zgjedhjet e vitit 2017. Çështjet objekt diskutimi kishin të bënin me:

- hartimin, dhe shpalljen e listës së zgjedhësve;
- ndarjen, bashkimin apo ngritjen e qendrave të posaçme të votimit;
- reduktimin e numrit të qendrave të votimit që i propozohen KQZ-së për t'u caktuar në ambiente private;
- sigurimin e ambienteve me kushte optimale pune për Selitë e KZAZ-ve dhe Zyrat Rajonale Zgjedhore;
- aksesin e Qendrave të Votimit ku votojnë zgjedhës me aftësi të kufizuara;
- përmirësimin e infrastrukturës së Vendeve të Numërimit të Votave.

KQZ-ja ndoqi ecurinë e punës, përmes informacionit të marrë nga nëpunësit e ngarkuar nga Kryetarët e Bashkive për të kontaktuar me KQZ-në. Angazhimi i Kryetarëve të Bashkive në përgjigje të kërkesës së KQZ-së, dëshmoi efektshmërinë e veprimtarisë së KQZ-së për fazën parazgjedhore të procesit zgjedhor të zgjedhjeve për Kuvend 2017.

VII.2 Plotësimi me modulet/programet kompjuterike të nevojshme të Sistemit të Integruar të manaxhimit Elektronik të Informacionit Zgjedhor.

Siç jeni në dijeni, KQZ-ja, me mbështetjen financiare të donatorëve, kryesisht të Zyrës së USAID-it në Shqipëri, ka filluar ndërtimin e një pakete të plotë programesh kompjuterike për administrimin e integruar të informacionit zgjedhor (Sistemi i Integruar i Manaxhimit të Informacionit Zgjedhor). Me projektin e realizuar deri në Zgjedhjet Vendore 2015, u zhvilluan dhe u përdorën një sërë modulesh/aplikacionesh që kanë mundur një administrim të suksesshëm të informacionit zgjedhor, veçanërisht për rezultatet zgjedhore, duke informuar në kohë dhe më saktësi publikun.

Menjëherë pas Zgjedhjeve Vendore 2015, KQZ-ja filloi punën e koordinimit me donatorë të ndryshëm, për të mundur ndërtimin e plotë të këtij Sistemi. Në fillim të vitit 2016, u konkretizuan me Zyrën e USAID-it në Shqipëri, termat e referencës për modulet e munguara në Sistem dhe pas sigurimit të financimit dhe caktimit të kompanisë nga donatori, mbi bazën e analizës së bërë, në muajin nëntor 2016, u përgatitën specifikimet teknike të moduleve/aplikacioneve kompjuterike. Është në përfundim zhvillimi i moduleve dhe pritjet të instalohen e testohen, për t'u përdorur, bashkë me modulet e përgatitura më parë, në zgjedhjet e Kuvendit 2017. Modulet që janë duke u përgatitur dhe që do të plotësojnë Sistemin e administrimit të informacionit zgjedhor janë:

1. Përshtatja për zgjedhjet e Kuvendit të modulit për menaxhimin e procesit për regjistrimin e subjekteve zgjedhore dhe listave shumemërore.
2. Përshtatja dhe zhvillimi i modulit për financimin e fushatës zgjedhore të partive, për shpenzimet e partive politike për veprimtarinë vjetore edhe në vit jo zgjedhor.
3. Moduli për menaxhimin e informacionit për ndarjet administrative dhe ato zgjedhore (qark, bashki, njësi administrative, zona të administrimit zgjedhor, vende të numërimit të votave, qendrave të votimit etj).
4. Moduli për menaxhimin e fletës së votimit, zgjedhjet rastësore në renditje, dizajnimi i fletës së votimit dhe përgatitja deri në printim.
5. Moduli për menaxhimin e të dhënave për administratën zgjedhore dhe vëzhguesit.
6. Moduli për menaxhimin buxhetor/financiar për komisionet e nivelit të dytë.
7. Moduli për shpërndarjen shpërndarjen e mandateve dhe ndjekjen në dinamikë të nominimeve nga një zgjedhje në tjetrën.
8. Moduli për përgatitjen e raporteve për buletin zgjedhor.

VII.3 Plani Orientues i Veprimeve

KQZ-ja, me nxjerrjen e dekretit të Presidentit të Republikës, nr.9883, datë 05.12.2017, për caktimin e datës 18 Qershor 2017, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin 2017, në kuadër të detyrimeve ligjore që ka, lidhur me organizimin, administrimin dhe kontrollin e procesit zgjedhor, miratoi një nga vendimet më të rëndësishme për procesin zgjedhor, vendimin për "Miratimin e planit Orientues të Veprimeve".

Plani Orientues i Veprimeve është një kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore, mbi të cilat do të mbështetet aktiviteti i mëtejshëm i KQZ-së. Plani Orientues i veprimeve, parashikon jo vetëm çdo akt nënligjor, të cilin KQZ-ja, duhet ta nxjerrë në zbatim të Kodit Zgjedhor (vendime, udhëzime, akte të thjeshta dhe akte normative), të cilat rregullojnë marrëdhënie të caktuara, si pasojë e ndryshimeve në ligj, ose ka lindur si nevojë nga praktikat e mëparshme zgjedhore, apo diktohet nga rekomandimet e OSBE/ODIHR-it.

Veprimet që parashikohen në këtë plan, burojnë nga detyrimet e përcaktuara nga dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe janë zbatimi i tyre në praktikë.

Detajimi i veprimeve konkrete dhe i afateve kohore, brenda të cilave këto veprime duhet të ndërmerren, duke iu referuar përcaktimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, ndihmojnë KQZ-në të kontrollojë në çdo moment, ecurinë normale të procesit zgjedhor, ndihmojnë partitë politike, vëzhguesit e huaj dhe vendas të orientohen në realizimin e procedurave dhe njëkohësisht të kontrollojnë ecurinë e procesit dhe veprimtarinë e KQZ-së.

VII.4 Aktet e miratuara në KQZ, gjatë vitit 2016, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 16 qershor 2017

Gjatë vitit raportues, vitit 2016, KQZ-ja **ka miratuar me unanimitet** dy vendime, që në zgjedhjet e mëparshme për Kuvendin, ato të vitit 2013, duke qënë se donin një shumicë të cilësuar, nuk ka mundur t'i miratojë. Me Vendim nr.172, datë 2.12.2016, u miratua ngritja e zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin 2017, duke lënë ato zona që ishin dhe në zgjedhjet vendore 2015. Gjithashtu me Vendim Nr.173, datë 03.12.2016, u miratua caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017. Siç dihet, mbështetur në numrin e popullsisë për çdo qark, sipas Vendimit të lartpërmendur të KQZ-së, numri i mandateve pati një ndryshim krahasur me zgjedhjet e mëparshme: qarkut të Tiranës dhe Durrësit iu shtuan përkatësisht dy dhe një mandat, dhe qarkut Berat, Korçë dhe Kukës u pakësua nga një mandat. Tani pritet që caktimi i numrit të mandateve për çdo qark të miratohet nga Kuvendi.

VIII. AKTIVITETE ME PARTNERË NDËRKOMBËTARË

VIII.1 Grupi Ndërkombëtar i Punës për Zgjedhjet - International Elections Working Group (IEWG)

Komunikimi i KQZ-së me faktorin ndërkombëtar ka qënë i vazhdueshëm dhe transparent. KQZ-ja, ka intensifikuar komunikimet me të gjitha organizmat ndërkombëtare të akredituara në vendin tonë, me qëllim identifikimin e fushave të bashkëpunimit në funksion të miradministrimit të procesit zgjedhor. Këto organizata, i kanë ofruar përkrahje, këshilla, ndihmë teknike e financiare KQZ-së. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka përfituar dhe do të përfitojë nga përvoja dhe mbështetja e mekanizmave ndërkombëtare, në arritjen e standardeve zgjedhore.

Gjatë vitit 2016, KQZ-ja ka marrë pjesë rregullisht në takime periodike, që organizohen me iniciativën e pranisë së OSBE-së, në kuadër të International Elections Working Group (IEWG). Prania e OSBE-së në Shqipëri, që prej shumë vitesh është organizatore e IEWG-së, një "tavolinë e rumbullakët", me përfaqësues të misioneve diplomatike të shteteve anëtare të OSBE-së në Tiranë, dhe organizatave ndërkombëtare me seli në Tiranë, që kanë objekt zgjedhjet. Synimi i kësaj "tavoline" është të njihet me zhvillimet më të fundit në fushën e zgjedhjeve, nga raportimet që bën vetë KQZ-ja ose organizma të tjera të lidhura me zgjedhjet. Gjithashtu synohet të koordinohen midis donatorëve, projektet e asistencës për zgjedhjet në Shqipëri, për të shmangur çdo mbivendosje të mundshme të saj. Këto takime i kanë shërbyer rritjes së transparencës së veprimtarisë së KQZ-së ndaj komunitetit ndërkombëtar, si dhe mbështetjes së strategjive të reja, të zhvilluara nga KQZ-ja për arritjen e standardeve të kërkuara për zgjedhjet e radhës.

Në këto takime periodike, KQZ-ja ka paraqitur një numër të konsiderueshëm projektidesh, në funksion të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të saj.

Gjatë vitit 2016, KQZ-ja, është mbështetur në aspektin financiar, nga Zyra e USAID-it në Tiranë, me qëllim ndërtimin e një pakete të plotë programesh kompjuterike për administrimin e integruar të informacionit zgjedhor, nga Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë për asistencë teknike e financiare,[si dhe] ngritjen e Qendrës të Trajnimit , asistencën teknike për hartimin e Planit Strategjik të institucionit të KQZ-së, nga prania e OSBE-së në Tiranë, për mbështetje financiare, për vizita studimore e pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare, etj.

VIII.2 Konferenca e 25-të vjetore e Shoqatës Evropiane të Zyrtarëve Zgjedhorë (ACEEEO).

Në shtator të vitit 2016, në Tiranë, u zhvillua Konferenca e 25-të vjetore e Shoqatës Evropiane të Zyrtarëve Zgjedhorë (ACEEEO), duke qenë se KQZ-ja e Shqipërisë ishte mbajtëse e Presidencës, për periudhën 2015-2016.

Punimet e konferencës nisën me mbledhjen e Bordit Ekzekutiv dhe të Asamblesë së Përgjithshme të ACEEEO-s, ku, me shumicë votash, u vendos anëtarësimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës në këtë Shoqatë.

Në këtë Konferencë, mori pjesë dhe pëshëndeti Z. Ilir Meta, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Zhvillimi i konferencës vjetore në Tiranë, përveç rëndësisë së tematikës së zhvilluar, kontribuoi në dhënien e një imazhi pozitiv të vendit tonë, si në rajon dhe më gjerë. Në Konferencë, ishin të ftuar zyrtarë të shoqatave homologe nga të gjitha kontinentet.

Konferenca u fokusua në aspektet më të rëndësishme dhe përparimet e proceseve zgjedhore në 25 vitet [vjetët] e fundit, që nga themelimi i Shoqatës. Tema kryesore e konferencës, "Zhvillimi i Sistemeve dhe Proceseve Zgjedhore", iu dha zyrtarëve zgjedhorë, një mundësi për të shqyrtuar tendencat kryesore, praktikat e 25 viteve të fundit, si edhe problemet që Trupat zgjedhore kanë pasur gjatë kësaj periudhe kohore.

VIII.3 Partneriteti me institucionet homologe dhe Organizma Ndërkombëtare .

Veç anëtarësimit në Shoqatën Evropiane të Zyrtarëve Zgjedhorë (ACEEEO), që prej themelimit të saj, KQZ-ja e Shqipërisë, është gjithashtu anëtare e Shoqatës Botërore të Trupave Zgjedhore (A-WEB), me qendër në Seul të Koresë. Kjo Shoqatë, e themeluar më 2011, përfshin në gjirin e saj 110 organizata të trupave zgjedhore të kontinenteve të ndryshme (Europa, Amerika,Afrika). KQZ-ja shqiptare, është anëtare e Bordit ekzekutiv të A-Web-it.

A-Web-i, organizon trajnime në aspektin teorik dhe praktik të problematikave, me të cilat trupat zgjedhore të vendeve të ndryshme sfidohen në punën e tyre. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Shqipërisë, si anëtar i kësaj organizate, ka përfituar nga

ekspertiza dhe asistenca e këtij mekanizmi ndërkombëtar, në arritjen e standardeve zgjedhore. Një nga aktivitetet e organizuara dhe të mbështetura nga A-WEB-i (Shoqata Botërore e Trupave Zgjedhore), ku KQZ-ja e Shqipërisë u ftua të marrë pjesë, ishte "Programi për Zhvillimin e Kapaciteteve të Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve" i cili u mbajt më 11-17 dhjetor 2016, në Incheon të Koresë së Jugut. Ky program ofroi një mundësi për shkëmbimin e njohurive zgjedhore ndërmjet zyrtarëve të TMZ-së.

KQZ-ja, vazhdon të ruajë marrëdhënie të mira dypalëshe me instancione të ngjashme, në funksion të përmirësimit të administrimit të procesit zgjedhor. Gjatë vitit 2016, KQZ-ja materializoi bashkëpunimin, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Trupat Zgjedhore të Rumanisë dhe Kosovës.

Gjatë vitit 2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me Qendrën për Perspektivë Evropiane (CEP), mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Sllovenisë, organizoi në Tiranë, seminarin "Forcimi i pavarësisë së organeve të Menaxhimit Zgjedhor, shkëmbimi i përvojave dhe mësimëve të nxjerra ndërmjet [në mes]Shqipërisë dhe Sllovenisë". Projekti u zhvillua në dy faza dhe synonte rritjen e standardeve demokratike të proceseve zgjedhore. Në këtë seminar, morën pjesë dhe shkëmbyen mendime, edhe përfaqësues të partive politike e shoqërisë civile shqiptare.

Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, i ka shërbyer shkëmbimit të eksperiencave dhe ka rritur dhe më shumë kapacitetet e KQZ-së. Vlen për t'u theksuar pjesëmarrja e KQZ-së ?Shqipëri në:

- Takimin e 6-të Vjetor të trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve (TMZ), me ftesë zyrtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Gjeorgjisë, nga 16-17 shkurt 2016.
- Vëzhgimin e zgjedhjeve në Bernë, Zvicër, zhvilluar më 28.02.2016, në nivel federal dhe në nivel kantoni.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Shqipërisë, si anëtar i Bordit Ekzekutiv të A-WEB-it, mori pjesë në takimin e katërt të Bordit Ekzekutiv në New Delhi, Indi nga 21-24 shkurt 2016.
- Takimin e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv të ACEEEO-s në Budapest, Hungari më 10.03.2016.
- Konferencën vjetore të zhvilluar nga Shoqata Ndërkombëtare e Nëpunësve, Llogaritarëve, Zyrtarëve zgjedhorë dhe e Financierëve, (IACREOT) në Memphis të Shteteve të Bashkuara, më 24 Qershor -1 Korrik 2016.
- Simpoziumin e 12-të Ndërkombëtar, për çështjet zgjedhore, zhvilluar nga ICPS-ja (Qendra Ndërkombëtare për Studime Parlamentare) në Swakopmund, Namibi nga dt.12-15 Qershor 2016.

- Bosnje Hercegovinë, me ftesë të A-WEB-it (Shoqata Botërore e Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve), lidhur me Programin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve, organizuar me rastin e zgjedhjeve lokale në Republikën e Bosnje Hercegovinës, që u zhvillua nga 29 shtator-05 tetor 2016;
- Konferencën ndërkombëtare për çështjet zgjedhore zhvilluar në Maputo, Mozambik më 17 nëntor, 2016.

IX. VERIFIKIMI I VETË DEKLARIMEVE TË FUNKSIONARËVE (DEKRIMINALIZIMI)

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, anëtarët e Këshillit të Ministrave që nuk janë deputetë, kryetarët e bashkive dhe këshilltarët në këshillat bashkiakë, në total 1815 funksionarë.

Mbështetur në ligjin nr.138/2015 dhe vendimin e Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", brenda afateve të përcaktuara, KQZ-ja ngriti strukturën e posaçme, pranoi, regjistroi me numër unik identifikimi cdo Formular Vetëdeklarimi, si dhe i skanoi duke i ruajtur elektronikisht ato. KQZ-ja me vendimin nr.12, datë 20.05.2016, vendosi të publikojë, në faqen zyrtare të internetit, formularët e vetëdeklarimit të funksionarëve publikë.

Në përfundim të afatit për depozitimin e formularëve të vetëdeklarimit, referuar pikës 3 dhe 4, të Kreut VI, të Vendimit të Kuvendit nr.17/2015, KQZ-ja bëri publike listën e funksionarëve që depozituan dhe të atyre që nuk depozituan formularët e vetëdeklarimit.

KQZ-ja në mbledhjen e datës 31.05.2016, shqyrtoi secilin rast individualisht, për ata funksionarë që nuk kishin depozituar formularin e vetëdeklarimit. Në këtë mbledhje KQZ-ja, referuar nenit 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, të gjithë funksionarët publikë që nuk kishin dorëzuar formularin në KQZ, në afatin e përcaktuar, ku rezultoi se:

1. 12 këshilltarë bashkiakë e kishin depozituar formularin e vetëdeklarimit, pranë një organi tjetër përgjegjës për dorëzimin dhe administrimin e formularit. Nga shqyrtimi i secilit rast individualisht rezultoi se, këta funksionarë publikë, duke qene se ushtrojnë dhe një funksion tjetër, përveçse atij të këshilltarit, kishin dorëzuar formularin brenda afatit pranë organit tjetër përgjegjës për depozitimin e formularit sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 3 të ligjit 138/2015.

Referuar nenit 24, pikës 2të ligjit nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative":, afati për kërkuesin vlerësohet i respektuar nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent.

KQZ-ja referuar dispozitave të sipërcituara, të ligjit nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", vendosi të pranojë formularin e vetëdeklarimit për këta 12 këshilltarë, duke i vlerësuar si të paraqitur brenda afatit ligjor.

2. Për 13 këshilltarë, të cilët e depozituan formularin e vetëdeklarimit në KQZ, pas datës 4 maj 2016, KQZ-ja vendosi pranimin e formularit dhe publikimin në faqen zyrtare të KQZ-së.

Në këto raste, KQZ-ja vlerësoi se, qëllimi i ligjit nr.138/2015, është "të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie, ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen e të krimeve" (neni 1 i ligjit 138/2015). Pranimi nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve i plotësimit të të dhënave pas afatit ligjor, i shërben qëllimit të ligjit, pasi ndihmon në bërjen e plotë të transparencës dhe verifikimit sa më real për të gjithë funksionarët publikë, që janë subjekt i këtij ligji. Vetëm verifikimi i plotë dhe transparenca për çdo të dhënë, në lidhje me dënimet penale, garanton besimin e publikut në organet e zgjedhura.

3. Për 18 këshilltarë bashkiakë, që nuk dorëzuan formularët e vetëdeklarimit, KQZ-ja shqyrtoi në seancë publike projektvendime për heqjen e mandatit, duke i trajtuar këto raste si refuzim për të deklaruar, ashtu si përcaktohet në Kreun VI, pika 4, të vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015".

KQZ-ja, brenda afatit të përcaktuar, kërkoi informacion për të gjithë funksionarët publikë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, përkatësisht për historinë e ndryshimit të gjenealiteteve dhe për gjendjen gjyqësore të funksionarëve që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ.

Nga verifikimi i dokumentacionit (formularit të vetëdeklarimit, dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti, vërtetimit të gjendjes gjyqësore dhe të gjendjes civile), rezultoi se:

Nga 140 deputetë:

- **121 prej tyre nuk kishin asnjë të dhënë të shënuar** në Formularin e Vetëdeklarimit apo në vërtetimet e gjendjes gjyqësore;

- **19 prej tyre** kishin plotësuar të dhëna në një ose disa nga rubrikat në Formularin e Vetëdeklarimit, apo kishin shënime në vërtetimet e gjendjes gjyqësore.

Nga 61 kryetarë bashkie:

- **50 prej tyre nuk kishin asnjë të dhënë të shënuar** në Formularin e Vetëdeklarimit apo në vërtetimet e gjendjes gjyqësore;
- **11 prej tyre** kishin plotësuar të dhëna në një ose disa nga rubrikat në Formularin e Vetëdeklarimit, apo kishin shënime në vërtetimet e gjendjes gjyqësore.

Nga 19 anëtarë të Këshillit të Ministrave, që nuk janë deputetë, **nuk ka patur asnjë të dhënë të shënuar** në Formularin e Vetëdeklarimit apo në vërtetimet e gjendjes gjyqësore.

Struktura e posaçme e krijuar me vendim të KQZ-së përgatiti projektaktet përkatëse për 12 deputetë dhe 6 kryetarë bashkie, Tabela nr.1 më poshtë, të cilat KQZ-ja i shqyrtoi në mbledhjen e datës 29 Korrik 2016.

Çdo rast përmbante analizën e detajuar të të dhënave nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti, vërtetimet e gjendjes gjyqësore dhe të dhënave për ndryshim gjenealitetesh.

Tabela nr. 1

Nr	Qarku	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat për vepra penale brenda/jashtë vendit
1	KUKËS	ALBAN	JONUZ	ZENELI	brenda
2	VLORË	ARBEN	PETRIT	RISTANI	brenda
3	LEZHË	ARMANDO	NDUE	PRENGA	brenda
4	TIRANË	EDI	TONIN	PALOKA	brenda
5	KORÇË	FATMIR	ALI	MEHDIU	(Itali) jashtë
6	TIRANË	PARID	NEZMI	CARA	(Itali) jashtë
7	VLORË	SHKËLQIMM	BASHKIM	SELAMI	(Itali) jashtë
8	TIRANË	SPARTAK	IBRAHIM	BRAHO	brenda
9	SHKODËR	TOM	GJEKË	DOSHI	brenda
10	GJIROKASTËR	VLADIMIR	LLUKAN	KOSTA	brenda
11	TIRANË	YLLI	VESEL	SHEHU	brenda

Nr	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat për vepra penale brenda/jashtë vendit
1	HAS	ADEM	AHMET	LALA	brenda
2	MALLAKASTER	AGRON	FASLLI	KAPLLANAJ	(Itali) jashtë
3	KURBIN	ARTUR	NDUE	BARDHI	brenda
4	POLIÇAN	ADRIATIK	MALIQ	ZOTKAJ	brenda
5	PUSTEC	EDMOND	VANGJEL	THEMELKO	(Maqedoni) jashtë
6	TEPELENË	TËRMET	NURO	PEÇI	brenda

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se asnjë nga funksionarët publikë të sipërcituar, nuk ishte në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

KQZ-ja, për deputetët Z.Shkëlqim Selami e Dashamir Tahiri, dhe kryebashkiakun Elvis Roshi, pasi iu vunë në dispozicion rezultatet e verifikimit të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme, vendosi për ndërprerjen e parakohshme të mandatit.

Për kryebashkiakun Artur Bushi, pas verifikimit të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme, kjo e fundit, konstatoi se nuk ka të dhëna për vepra penale të parashikuara nga neni 2 i ligjit 138/2015, të cilat përbëjnë shkak për ndërprerjen e parakohshme të mandatit.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se: funksionarët, (**sipas Tabelës nr.2**), tre kryetarë bashkie dhe tre deputetë, nuk kishin shënime në rubrikat e formularit të vetëdeklarimit, por sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, rezultoi se kanë dënime me vendim të formës së prerë, fillim të procedimit penal, apo rezultoi se *kanë qenë në gjykim për një vepër penale* [nga gjykatat shqiptare], por janë shpallur të pafajshëm ose çështja është pushuar për vepra penale të cilat nuk përfshihen në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Tabela 2

Dëshmi penaliteti nga ZGJGJ							
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Gjykata/ organi	Nr. dhe dt. e vendimit	Masa e dënimit	Të dhënat për vepra penale

Kryetarë bashkie

1	NDREC	NDUE	DEDAJ	Tiranë	Nr.779, dt. 14/07/2006	gjobë 100.000 lekë	Kryerje veprime arbitrare, neni 250
				Apeli Tiranë	Nr.20, dt. 17.01.2007	prishje e vendimit dhe pushimi i çështjes	Kryerje veprime arbitrare, neni 250
2	ZEF	KIN	HILA	Shkodër	Nr.474, dt. 21.12.2007	I pafajshëm, neni 248	Shpërdorim detyre
				Apeli Shkodër	Nr.79, dt. 25.03.2008	lënie në fuqi por ndryshim nga "fakti nuk ekziston" ne "nuk përbën vepër penale"	Shpërdorim detyre
3	ADEM	AHMET	LALA	Kukës	Nr.21, dt. 23.04.2004	gjobë 40.000 lekë	Neni 246/1 i kodit penal

Deputetë

1	ARMANDO	NDUE	PRENGA	Kurbin	Nr. 163, dt. 01.12.2005	300.000 lekë gjobë	Fallsifikim dokumentash . Neni 186/1 i Kodit Penal
2	ASLLAN	SHABAN	DOGJANI	Gjykata e shkallës së parë dhe e apelit Shkodër	Nr. 317, dt. 24.11.2004	Pushim Gjykimi	Shpifje dhe përhapje e qëllimshme e informacioneve që dihet se janë të rrreme. Neni 119 i Kodit Penal
3	FLORIAN	PROKOP	MIMA	Gjykata Tiranë	Nr. 442, dt. 07.04.1995	I pafajshëm	Vepra penale e Shpifjes. Neni 186 i Kodit Penal

Referuar nenit 45/3 i Kushtetutës dhe nenit 2 të ligjit 138/2015, përjashtohen nga e drejta për t'u zgjedhur shtetasit që janë dënuar:

- 1) me burgim;
- 2) me vendim të formës së prerë;
- 3) për një krim;

kur janë vërtetuar të 3 këto elemente, në mënyrë kumulative.

Ligji nr.138/2015, përveç listimit të një numri të *mbyllur krimesh* ka renditur edhe dënimet me vendime jopërfundimtare dhe masat e sigurimit apo të dëbimit, por në çdo rast duke përjashtuar veprat e tjera penale (rrjedhimisht edhe gjobat apo kundërvajtjet penale). E detyruar të zbatojë këto rregullime kushtetuese e ligjore, KQZ vlerëson se, funksionarët publikë kanë detyrimin të deklarojnë vetëm të dhëna për dënime me burgim, të dhëna me vendime të formës së prerë ose jo, si dhe mbi masa sigurimi apo vendime dëbimi të dhëna nga autoritetet ligjzbatuese të huaja.

Bindja jonë për sa më lart mbështetet plotësisht edhe nga neni 5 i ligjit 138/2015, që saktëson se:

"1. Personat e parashikuar nga nenet 2 dhe 3, të këtij ligji, duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar."

Pra, subjektet deklaruese kanë detyrim të deklarojnë vetëm *mosekzistencën e shkaqeve* për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar, dhe jo çfarëdo të dhëne tjetër e cila nuk përfshihet në qëllimin e ligjit për dekriminalizimin. Përndryshe do të ndodheshim përballë një paradoksi sipas të cilit, nëse e deklaroi p.sh. një dënim *me gjobë*, nuk prekesh nga penalitetet e ligjit për dekriminalizimin por, nëse nuk e deklaroi, duke qenë se gjopa formalisht është dhënë me një "dënim gjyqësor të formës së prerë", për shkak të pasqyrit të të dhënave të rreme apo jo të plota në *formular*, duhet të dënohesh me burg dhe të humbasësh funksionin publik.

Një ndër parimet bazë të interpretimit të ligjit është përzgjedhja e atij interpretimi që është sa më i arsyeshëm dhe që cenon sa më pak liritë dhe të drejtat individuale. Neni 17 i Kushtetutës detyron që "kufizimet ndaj lirive dhe të drejtave të parashikuara nga Kushtetuta mund të vendosen vetëm me ligj" dhe jo me akte të tjera, qofshin këto edhe vendime të Kuvendit. E drejta për t'u zgjedhur dhe e drejta për punë, janë dy të drejta kushtetuese të cilat nuk mund të kufizohen përmes rregullimesh ekstra-ligjore (vendime a formularë). Kujtojmë që, përveç këtyre dy të drejtave kushtetuese, është në lojë edhe dinjiteti njerëzor i këtyre individëve.

Disa funksionarë publikë, sipas **tabelës nr.3**, kanë depozituar në KQZ kërkesë për plotësim të të dhënave në formularët e vetëdeklarimit, ndonëse pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 15, pika 2, e ligjit. Kërkesat e tyre për plotësimin e të dhënave kanë qenë ose për ndryshim gjenealitetesh, ose për të dhëna mbi dënime me gjobë për shpifje, armëmbajtje pa leje, fyerje etj. Vetëm 1 kërkesë për plotësim, është bërë për dënim me burg (45 ditë), për kalim të paligjshëm kufiri në vitin 1990.

Këto kërkesa, janë depozituar dhe pranuar në KQZ gjatë periudhës Qershor-Korrik 2016.

Tabela 3**Deputetë**

Nr.	Qarku	Emri	Atësia	Mbiemri	Për çfarë/ dënimi
1	VLOREË	ARBEN	PETRIT	RISTANI	Shpifje për shkak të detyrës, dënuar me gjobë 200 mijë lekë në vitin 2015
2	TIRANË	ARTAN	ILIA	GACI	Kundërvajtje penale, dënuar me gjobë 300 mijë lekë , shpallur i pafajshëm në vitin 2009
3	TIRANË	SPARTAK	IBRAHIM	BRAHO	Shpifje të bërë botërisht, dënuar me gjobë 10 mijë lekë në vitin 1995
4	GJIROKASTË	VLADIMIR	LLUKAN	KOSTA	Armëmbajtje pa leje, dënuar me gjobë 10 mijë lekë në vitin 2000.
5	TIRANË	YLLI	VESEL	SHEHU	Kontrabandë, dënuar me gjobë 200 mijë lekë në vitin 2007
6	TIRANË	SALI	RAM	BERISHA	Ndryshim gjenealitesh (emër, datëlindje)
7	TIRANË	XHEMAL	MYSLIM	QEFALIA	Ndryshim gjenealitesh (mbiemër)

Kryetarë bashkie

Nr.	Bashkia	Emri	Atësia	Mbiemri	Për çfarë/ dënimi
1	KURBIN	ARTUR	NDUE	BARDHI	Kalim i paligjshëm kufiri, dënuar me 1,5 muaj burg ne vitin 1990
2	POLIÇAN	ADRIATIK	MALIQ	ZOTKAJ	Fyerje e goditje për shkak të detyrës , dënuar 4 muaj riedukim nëpërmjet punes dhe me gjobë 200 lekë në vitin 1985
3	PUSTEC	EDMOND	VANGJEL	THEMELKO	1. Kontrabande/denim me kusht 1995 ne Maqedoni, rehabilituar; 2. Hetuar per manipulim zgjedhjesh ne Maqedoni ne vitin 2015, amnistuar.
4	MIRDITË	NDREC	NDUE	DEDAJ	Kryerje veprime arbitrare, denim me gjobe, apeli e ka pushur çeshtjen.
5	TEPELENË	TËRMET	NURO	PEÇI	Falsifikim dokumenti/ denuar me 100 mijë lekë gjobë mije leke gjobë në vitin 2004

KQZ edhe edhe për ato subjekte që kanë sjellë në KQZ informacione shtesë ka ndjekur të njëjtin interpretim logjik të ligjit 138/2015. Duke i siguruar me vetë vullnetin e tyre, ata kanë ndihmuar në verifikimin e plotë e të gjithanshëm të situatës së tyre juridike në kuptim të ligjit për dekriminalizimin, qëllimi i të cilit është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve shtetërore, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët nuk janë të denjë në kuptim të ligjit, por jo të personave që për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme për të përfutur në kundërshtim me ligjin, kanë deklaruar të dhëna shtesë pas përfundimit të afatit të deklarimit.

Në respekt të arsyetimit të shpalosur më lart, KQZ ka gjykuar se duhet të bëjë kallzim penal vetëm për ata funksionarë që nuk kanë deklaruar *dënime të cilat përbëjnë shkak për përfundimin e ushtrimit të funksionit*. Në rastin e funksionarëve të sipërcituar të dhënat e pa deklaruara nuk përbëjnë shkak për ndalim të ushtrimit të funksionit apo për kallzim penal.

Për 10 funksionarë publikë, 7 deputetë dhe 3 kryetarë bashkish, të cilët me vendim të formës së prerë janë shpallur të pafajshëm ose ndaj të cilëve është pushuar çështja, KQZ-ja vlerësoi se nuk janë subjekt i ndalimit sipas këtij ligji, konkretisht:

Deputetë:

1. Artan Gaçi – akuzuar për kundërvajtje penale më 2006 dhe shpallur i pafajshëm me vendim të Gjykatës së Lartë Nr.570, datë 14.11.2009 (e vërtetuar nga vetëdeklarimi dhe nga dëshmia e gjendjes gjyqësore).
2. Asllan Dogjani, nuk ka deklaruar në formular, por nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore rezulton:
 - akuzuar më 1995 për shpifje dhe shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë të Gjykatës;
 - akuzuar për shpifje më 2004 dhe pushuar gjykimi me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Shkodër.
3. Blendi Klosi – akuzuar më 1994 për sjellje të padenjë në shoqëri dhe pushuar gjykimi (e vërtetuar nga vetëdeklarimi dhe nga dëshmia e gjendjes gjyqësore).
4. Florian Mima - nuk ka deklaruar në formular, por nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore rezulton:
 - akuzuar më 1995 për shpifje dhe shpallur i pafajshëm me vendim gjyqësor Nr.442, dt. 17.04.1995.
5. Luan Rama – akuzuar më 1995 dhe dënuar nga gjykata e shkallës së parë me gjobë 100 mijë lekë, për shkelje ligji dhe pushim gjykimi dhe prishje vendimi me

vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë Nr..., dt.18.12.1995 (e deklaruar ne formular dhe e paregjistruar në vëtetimin e gjendjes gjyqësore).

6. Mhill Fufi ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe i paregjistruar në vëtetimin e gjendjes gjyqësore :
 - akuzuar, ndaluar me arrest në vitin 2001 për favorizim prostitucioni dhe me vendim gjykate, ka pushim procedimi;
 - akuzuar në vitin 1998 për organizim dhe pjesëmarrje në tubim të paligjshëm dhe me vendim gjykate ka pushim procedimi.
7. Pjerin Ndreu ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe i paregjistruar në vëtetimin e gjendjes gjyqësore:
 - akuzuar dhe masë shtrëngimi paraqitje për përdorim me keqdashje të thirrjes telefonike në 2004 dhe shpallur i pafajshëm nga Gjykata.

Kryetar bashkie

1. Ndrec Dedaj, nuk ka deklaruar në formular, por nga vëtetimi i gjendjes gjyqësore rezulton:
 - akuzuar në vitin 2006 dhe dënuar nga Gjykata e Tiranës me gjobë 100 mijë lekë për kryerje të veprimeve arbitrare, por me vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë, është prishur vendimi dhe pushuar çështja.
2. Xhelal Mziu – akuzuar e arrestuar për shpërdorim detyre dhe shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë me vendim Nr.297, datë 22.04.2016 (e deklaruar ne formular dhe e paregjistruar në vëtetimin e gjendjes gjyqësore).
3. Zef Hila – akuzuar në 2007 për shpërdorim detyre dhe shpallur i pafajshëm me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Shkodër (nuk ka deklaruar në formular por rezulton nga vëtetimi i gjendjes gjyqësore).

KQZ gjatë vitit 2016 ka verifikuar për **1595** anëtar të këshillave bashkiak që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ. Verifikimin e plotë për këta funksionarë publikë KQZ e përfundoi në vitin 2017, pasi mori informacionin nga zyra e gjendjes civile.

Referuar nenit 11 të ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, **kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak**, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant .

Kandidatët për këshilltarë, përcaktuar në bazë të listave **shumemërore** të subjekteve përkatëse, kanë plotësuar e depozituar në KQZ formularët e vetëdeklarimit. KQZ-ja për të gjithë këta, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, si dhe ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Gjatë vitit 2016, KQZ-ja ka pranuar, regjistruar dhe përpunuar formularët e vetëdeklarimit për 84 kandidatë për anëtarë të këshillave bashkiakë.

Gjatë vitit 2016, KQZ-ja gjithashtu ka pranuar, regjistruar dhe përpunuar formularët e vetëdeklarimit edhe për katër kandidatë për kryetarë bashkie, përkatësisht nga dy kandidatë që konkuruan për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkinë Dibër e Kolonjë.

KQZ-ja e ka treguar qartësisht vullnetin në lidhje me zbatimin e ligjit për dekriminalizimin. Në të gjitha rastet kur prokuroria dhe organet e tjera i kanë vënë në dispozicion materialet e mjaftueshme në lidhje me subjekte të caktuar, KQZ-ja nuk ka hezitur për asnjë çast dhe ka vendosur menjëherë ndërprerjen e mandateve të deputetëve, kryebashkiakëve apo këshilltarëve bashkiakë.